



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PALLATIT KASTRATI, NR.14, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, shkresës së Komisionit të Posaçëm nr. prot 9462/3, datë 15.07.2026, që u mor në shqyrtim nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 17.07.2026 dhe sipas relacionit të këshilltarëve prezent në mbledhje,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit, banorë të pallatit Kastrati, Nr.14, Rruga "Ramadan Veliu" sipas Aneksit 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE



U shpall sot me datë 27.07.2026

Aneksi 1 . Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit Kastrati, nr.14, rruga “Ramadan Veliu”.

NR	PRONARI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA	PALLATI	SIP.NË M ² QE DO TE PËRFITOHE
1	Arlind Beluli	5	3+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	120
2	Feim Kastrati, Fidane Kastrati	5	3+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	101
3	Albano Jovani	4	2+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	119
4	Behar Caci, Naxhije Caci	2	1+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	70
5	Devi Dauti	1	1+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	86
6	Mhill Pjetri, Tringe Pjetri	2	1+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	78
7	Sejdi Kastrati	4	2+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	86
8	Irfan Balla	4	2+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	125
9	Ana Kebej	4	1+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	86
10	Ronaldo Kebej	1	3+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	182
11	Muhamet Vata	6	3+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	130
12	Shefqet Mustafa, Safete Mustafa (Imeri)	6	3+1	PALL KASTRATI, RAMADAN VELIU	126





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 596/ prot.

Durrës, më 31 . 07 . 2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.62 datë 17.07.2026, “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit Kastrati, Nr.14, rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

